



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
 OPŠTINA LIPLJAN
 MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 16-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 28.02.2023, në sallën e Kuvendit, në objektin e ri të komunës me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtare
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Sami Bytyqi, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Xhyzide Rustemi, anëtare
11. Rinor Murati, anëtar
12. Armend Grajqevci, anëtar
13. Majlinda Sylejmani, anëtare
14. Gentianë Hoxhaj, anëtare
15. Venhar Agushi, anëtar
16. Xhyla Dedushaj, anëtare
17. Lulzim Rustemi, anëtar
18. Herolind Kozhani, anëtar
19. Ardit Cani, anëtar
20. Arsim Jashari, anëtar
21. Egzona Bytyqi, anëtare
22. Lumturiye Bytyqi-Hasani, anëtare
23. Ganimete Qeriqi, anëtare
24. Alban Salihu, anëtar
25. Fitim Meziu, anëtar
26. Fadil Spahiu, anëtar
27. Fatmir Fetahu, anëtar
28. Shahadije Dragacina, anëtare
29. Besiana Sylja, anëtare
30. Enver Kryeziu, anëtar
31. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i komunës
2. Diamnt Bytyqi, nënkryetar i komunës
3. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i Komunës për komunitete
4. Latif Ramadani DBF
5. Anila Reçica, DKRS
6. Valon Pacolli, DEZH
7. Shkelzen Hajdini, DSH
8. Flamur Sylejmani, DI
9. Elmaze Behluli, DA
10. Sead Aliu, DI
11. Rexhep Rexhepi, DBP
12. Rasim Hasani, DA
13. Safete Amerrlahu, DGJK
14. Përfaqësues të medieve dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 15-të e Kuvendit.
2. Propozim Vendim për rritjen e buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2022. Komuna
3. Propozim-vendim për dhënien e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Lipjanit nga viti 2022 në vitin 2023.
4. Propozim Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15 Nr.011-43473 datë 28.06.2019.
5. Propozim Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës së Lipjanit.
6. Raporti Janar - Dhjetor 2022 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorive Komunale.

Pastaj tha se pikën e 2 dhe 3-të e tërheqim nga rendi i ditës për shkak të harmonizimit me Ministrinë e Transfereve, ashtu siç jeni njoftuar edhe përmes emailit.

Po ashtu do ta keni edhe një pike shtesë e cila e ka marrë edhe rekomandimin e KPF-së, të 5 tën me rradhë pasi që tani po mbesin vetëm 5 pika.

7. Propozim Vendim për aprovimin e listës së projekteve kapitale me prioritet për bashkëfinancim për vitin 2023

Pastaj Kryesuesi pyeti se a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës?

Pastaj e futi në votim rendin e ditës se pari te hiqet pika 2 dhe 3 si dhe te shtohet pika e 7 me te gjitha votat per 30 kaloi, pastaj u hodh ne votim rendi i dites i kompletuar dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 30 vota për, aprovoi rendin e ditës..

Pastaj u kalua në Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Armend Grajqevci, tha se e kam një kërkesë për drejtorinë përkatëse për vendosjen e barrierave afër shkollës “Kadri Beba” në Ribar të Madh,si dhe këndin e lojrave në oborrin e shkollës.

Albiona Tasholli, tha se kam disa çështje për ti ngritur,e para a ka mundësi të ndahet buxhet qe nxënësit nga klasa 1 deri në 5 te paise me dollapa në shkollë,ne menyre qe te ju hiqet barra për shkak se po ndikojnë negativisht te femëjët.E dyta ka të bëjë me zyrën e vendit në gadime e cila tani per tani nuk i plotëson aspak nevojat e qytetarëve dhe nuk i ka aspak kushtet e duhura per punë.Të pakten te rinovohet ajo, por nëse nuk ka mundësi te rinovohet te mirret leje per ti shfrytezuar dy zyre përballë Shpellës.E treta, te Shepela e mermerit ka shqetësime pasi qe punetoret po punojnë aty nuk po kanë sjellje të mirë, kërkoj nga ana juaj ti shfrytëzoni të gjitha mundësitë qe ajo shpellë te na kthehet neve.

Arsim Jashari, tha se se kam disa kërkesa dhe pyetje. Kërkesa e parë ka të bëjë me banorët e lagjes Malet e Sharrit në Lipjan ku kërkojnë të vendosen shportat statike, e dyta me Lagjen Kruja në fshatin Gllgovc, është një rrugicë në gjendje të tmerushme, po ashtu edhe tensioni i lartë i rrymes është ne gejdje jo te mire edhe pse nuk është kjo kompetencë e juaja. E treta ka të bëjë me banorët e rrugës së Lumit në Gadime,ku gjendja në atë rrugë është e mjerushme, dhe kërkoj nga ana juaj të intervenoni, kërkesa e 4 -ka të bëjë me hedhjen e mbeturinave ne shkollën e vjetër në rrugën Banullë Gllgovc. Pyetja është se është anuluar një konkurs, për gabim teknik, për çfar gabimi teknik bëhet fjalë. Dhe e pyetja e fundit për DKRS-në,në stadiumin e Dobrajës është një invertar i cili është donacion , por pasiq e ka pas reshje te shiut aty ka hyr uji brenda, çka keni ndërmarrë ju qe ai invertar aty mos të dëmtohet.

Shahadije Bikliqi, tha se kam për ti ngritur disa kërkesa dhe shqetësime të qytatarëve, e para ka të bëj me mos ofrimin e shërbimeve stamatologjike në QKMF-në Lipjan konkretisht mbushja e dhëmbëve në ndërrimin e pasditës. E dyta përfaqesuesi i komuniteteit serb në Komitetit për Komitete është ankuar se rruga në

fshatin Grackë nuk është shtuar edhe pse janë bërë kërkesa disa herë. Këta krahas asfaltit po kërkojnë të ket edhe trotuar me ndriçim publik. Tjetra ne faqen zyrate te komunës shumë pak publikohet rreth punës së Kuvendit, por kryesisht publikohet puna e kryetarit dhe ekzekutivit e qe kjo nuk është e drejtë.

Rinor Murati, tha se kam dy pyetje për ekzekutivin, e para a është duke u bërë vendosja e flamujve të prdukteve në markete. Si është duke shkuar pasisja me dokumente të identifikimit si pasaporta letërnjoftime e dokumente tjera.

Ardit Cani, tha se se kam disa kërkesa, e para është një kërkesë e prindërve të fshatrave Baincë, Risnovc, Shalë, Krojmir, ku sipas tyre bilete e autobusit per nxënës dhe studentë, është njet sikurse per punëtorët e kan kërkesë, qe nëse ka mundësi DKA-ja, të bëjë një zgjidhje për këtë çështje duke mundësuar lirimimin e biletave per ta. E dyta kryesia e fshatirt Risnovc, kanë kërkesë per kanalizimim i cili është i bllokuar. Tjetra ka të bëjë me pastrimin e lumit “Drenica” e cila është në gjendje te mjerushme.

Ganimete Qeriqi, tha se e kam një pyetje për kryetarin ose kush do qe e ka argumentin. Edhe ma parë e kam berë kete pyetje ,pyes edhe tani tani qe po hyjmë ne mujtë e pergjakshëm ,muajtë e kauzave,janë pervjetoret e martireve. Qysh është vizioni i juaj politik për familjet e martireve ,a do te shperblehen me banesa ose shtepi,siç e don rendi.Pasi qe une mendoj se duhet me u gjete mundesi te dhe me u bë zgjidhje kesaj kategorie. Kjo pune nuk bëhet sot ,as naser por ne te ardhmen duhet me qene aktuale dhe me u levize kjo pune e mos me u lan ne harrese kjo kategori e shoqerise. Pytja e dytë ka pasur nismë të disa asambleisteve per strehim te qenve endacak,deri ku ju ka mbririt puna e menaxhimit per qenët endacak dhe qenve me pronar ,a eshte duke u inspektuar kjo pune. Se rruget ,sheshet dhe parqet jan plote qenë endacak.

Alban Salihu, tha se i kam disa çështje për ti ngritur, e para para disa dite e kemi vizituar QKMF, dhe shqetusuese është inventari i hudhur mbrapa objektit, ku drejtori ka thënë do ti nënshtrohen procedurave ta ankandit, si do te dalin ne ankand publik ato ne atë gjendje te mjerueshme qe janë.E dyta, para disa dite është bërë disa organizimi per ditën e pavarsisë nga DKRS-ja, dhe organiata e cila i ka bërë këto organizime nese e shikon ne faqen e tyre aktivitetet e para qe i ka organizuar jane keto dhe nuk ka asnje aktivitet tjetër shihet qe ka qenë një organziatë e pa përvojë ku këtë kanë mujtë ta organizojnë edhe zyrtarët e këtij drejtorati. Pyetje për DKA-në para disa dite kemi vizituar shkollën në Blinajë, dhe aty nuk po zhvillohej mësimi po nxënësit po vijojshtin mësimin në Magure, a ka mundësi një sqarim për këtë çështje. Tjetra

konkurset te cilat po shpallen nga DKA-ja, kur po shpallen rezultatet, do te ishte më transparente sikur te dilte rezultati me pikë të sakta secilit kandidat.

Gentianë Hoxhaj, tha se kam një pyetje për DKRS-në, a keni të parapar në buxhet subvencionimin e lexuesve më të mirë ose lexuesit me të mirë në bibliotekën e qytetit, pasi q ekjo do të i motivonte te rinjtë e komunës tonë. Dhe a do të investohet në kabinat e leximit.

Lulzim Rrustemi, tha se e kam një propozim per pike per mbledhjen ardhshme, një raport financiar nga kompania, Pastrimi per gjendjen e tyre financiare. E dyta kam kërkesë nga qytetarët e fshatit Rubovc për një mësimdhënës për parashkollor në Rubovc. E dyta kanë kërkesë banorët e Rubovcit të bëhet aktivizimi i ujësjellësit në fshat pasi qe uji nuk i plotëson nevojat e tyre. E treta kërkesë është per rrugën Marie Shllaku qe te ndërtohet ura mbi lumin Sitnica, pasi qe është shumë e nevojshme për banorët e fshtarve Rufc dhe Hallaq. Kërkesë ka edhe nga banorët e Jetës së Re, për ujësjellës dhe kanalizim si dhe rregullimin e rrugicave.

Besiana Sylja, tha se se kam disa pyetje, e para ka të bëjë me rrugën me emër të veprimtarit Avdi Qadraku në Blinajë ku ka ankese nga këta banorë, se ka mebtur vetëm Qadraku, dhe jo si do te duhej te jet Avdi Qadraku, çka po ndodh me këtë. E dyta ka të bëjë me banorët e lagjes së Akllapit të cilët po ankohen qe nuk po ju bëhet më pagesa për bus siç ka qenë më hertët, duhet te ju bëhet një zgjidhje këtyre banorëve. Në fshatin Krojmir në shkollën fillore është ndërtuar kulmi i shkollës por ai është i ndërtuar nga llamarina dhe po shkakton zhurmën për nxënësit gjatë reshjeve të shiut.

Egzona Bytyqi, tha se, kam për ti ngritur disa çështje, e para sa i përket retnngenit në QKMF, nuk e kam të qartë prejardhjen e tij a bëhet fjalë për donacion apo për atë qe e kemi papara në buxhet për vitin ne vijim në kuvend. E dyta ka të bëjë me fenomenin e shitjes se barnave pa recetën e mjekut qe është një dukuri shqetësuese qe e atakon të gjithë vendin. Dhe e funksit kur ka me u fuknksionali faqja zyrtare e QKMF-së, për shkak se qytetarët kane nevojë për informim.

Lumturie Bytyqi-Hasani, tha se, të dielen është vënë gurthemeli i memorialit në Shalë, dhe ky projekt është nisur me vetfinancimine këtyre banorëve dhe do të ishte mirë qe edhe komuna të ndihmonte këtë aktivitet, po ashtu aty ne kodren e Shalës do të vendosen edhe shkronjat e UÇK-së, do të ishte mirë qe komuna të bënte rregullimin e rrugës së bashku me trotuar dhe me një miniparking per vizitorët. Do të ishte mire qe komuna ta ndaj buxhet për këtë projekt madhështor. Qështja e dytë, para disa kohe

në Kuvend është ngritur çështja e rregullores për orarin e bizneseve nga asamblisti Fadil,desha me ditë a ka ndonjë nismë për këtë rregullore.

Fadil Spahiu, tha se, kam dy kërkesa e parë është nga banorët e fshatit Varigoc të cilët kanë bërë kërkesë që të bëhen investime në Infrastrukturen e fshatit të tyre, të cilat janë elementare për zhvillimin e jetës normale, duke i renditur si: Ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit dhe furnizimi me ujë të pishëm, ndërtimin e trotuarit dhe ndriçimi publik brenda fshatit, zgjerimin e rrjetit të kanalizimit, sepse ende nuk janë kyqur disa shtëpi të familjeve Zeqir dhe Sahiti si dhe rrethimi i fushë së hapur të futbollit që është ndërtuar në këtë fshat. Këto kërkesa banorët e këtij fshati i kanë bërë disa herë pranë organëve kompetente Komunale, por, asnjëra nga këto kërkesa ende nuk kanë filluar të implemetohet. Ndërsa kërkesa e dytë është për Drejtorinë e Inspektoriatit,dëshiroj ta ngris një qështje e cila në esencë krijon mbeturina si në qytet, po ashtu edhe në fshatra. Është fjala për fletushkat e ofertave të rrjeteve të super marketeve të cilat shpërndahen gjithandej. Kam pasur disa ankesa lidhur me këtë problematikë, sepse vërtet kontribon në ndotje. Dëshiroj të jem i sqart, pasi që qëllimi im është të ngris qështje jo për të akuzuar, por për të evituar problem. Prandaj e kam informuar që inspektoriatin e ka trajtuar këtë problematikë, pra nuk i ka ikur pa e vërejt, mirëpo kisha kërkuar të mirren masa ndëshkuese për të pa përmisueshmit. Pra, të ndëshkohen të pa përmisueshmit.

Bashkim Budakova, tha se kam një pyetje për ekzekutivin, cilat janë kriteret për pranimin teknik të një objekti ndërtimi dhe çfarë kriteresh duhet të plotësojë një objekti që të pranohet teknikisht?

Alban Salihu, tha se e kam pranuar një ankese nga banorët e objektit të Eurokosit, ku kanë probleme me parkingun,ku siaps këtyre banorëve vijnë i parkojnë veturat edhe qytetar të tjerë në parkingun e tyre, dhe këta banorë e kanë dërguar edhe një peticion në komunë, pse nuk ka ardh ai peticion në kuvend.

Fitim Mëziu, tha se,te QKMF-ja, funksionon edhe objekti i Kryqit të Kuq, ku aty bëhen kërkesa të ndryshme, dhe do të ishte mirë që komuna sipas mundësive të gjej një objekt tjetër përkomisist, pasi që aty nuk i plotëson kushtet ai objekt, dhe do të ishte mirë që të ndahet një objekt përmes kuvendit komunal për ndërtimin e tij.

Gazmend Qerkini, tha se kam një pyetje për kryetarin për investimet të cilat janë duke u bërë në Janjevë, cili është projekti?

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se, shkolla në Ribar të Madh po punohet dhe këtë vit pritet me përfunduar dhe do të vazhdohet edhe me pjesën e jashtme të

infrastrukture ne shkolle. Te dollapet në shkolla patem fillu me i bërë, por ne jemi koncetruar ne bartjen e nxënësve prej parafillor deri në klasin e 5-të. Por edhe dollap mund ti bëjmë por sa jane funksionale ju e velërsoni. Te zyret e vendit kemi te njeten problem dhe edhe ne si disa komuna duhet ti mbyllim prap se prap qytetaret po vijnë ne Lipjan. Por une e ndaj mendimin qe keto duhet te mbyllen. Shpella e Mermerit ne Gadime, nuk menaxhohet nga ana jone por nga niveli qendror por është mirë ju si kuvend me bërë një kërkesë qe ajo të menaxhohet nga komuna. Sa i përket shprotave statike ne i kemi vendosur ne shumë vende, por ato po na mbushen me mengjes nga familjet e dnryshme, dhe nuk po kujdesen si duhet po harroje qe ato janë për mbeturina te kalimatrve e jo te familajrve. Rruga në Glllogovc qe lidhet me Bujarinë, është prioritet dhe do te asfaltohet. Shtyllat elekrike nuk janë kompetencë e komunës, por ne shumë raste po na prishin rrugen KEC-i, Ujësellsi dhe nuk po e riparojnë. Rruga e Lumit në Gadime është me prioritet ajo ka qenë e kontraktuar po ka mbet në gjsyme siç ka mbet edhe ajo ne Rubovc dhe shumë rrugë tjera. Na kemi shumë herë edhe probleme pronësore gjatë asfaltimit të rrugicave. Te konkursi në fjalë ka qen një gabim teknik te data. Te stadiumi i Dobrajës, ne ju kemi derzuar edhe nje motor per ksitjen e barit, por nuk po menaxhohet si duhet, ashtu siç kemi telashe me menaxhim te fushave te vogla neper fshatra.o shoh shpesh kërkesa te qytatarëve, mos thunar kërkesë e qytatarëve por kërkesë e një qytatari, se jo qe joq e jeni kane edhe shumë aktiv me takime me qytatarët. Dhe ka pas edhe disa deklarime se duhet me dhënë dorëheqej, une po ju them se do të jem këtu deri në vitin 2055. Vendorsja e flamujve në produkte, është bërë, bile ka pas edhe gjoba nga inspektoriati. Sa i perket pasportave e leternjoftimve nuk jam ne dijeni se nuk është kompetencë e jona. Sa i përket biletave te kerkohet qe te nderyjme ne nuk ekmi te drejtë, por qe te subvneconehen nuk kemi mundësi . Lumenjtë jam hapur shumica. Problemin me te madh mun ta kemi me Lumin Konjuh edhe pse kemi investuar disa herë aty. Disa shkolla janë në renovim dhe do të kryhen shpejtë. Por ne kemi probleme ne disa shkolla ku kanë shumë pak nxënës dhe do te kemi nevoj per ristetmim. Sa i perket konkurseve ka ligje dhe udhëzime të cilat referojnë dhe udhëzojnë dhe na bazohemi në to. Sa i përket lexuesve dhe botuesve te librit do te kemi këtë vit. Kabinat për lexues do të rregullohen. Sa i përket raportin nga kompania Pastrimi mund ta kërkojmë, por une nuk jam i mendimit qe kjo kompani të menaxhohet nga komuna. Na e kemi votu ketu në kuvend per nje kompani, por ende jemi duke prite nga Minsitria qe dy vite dhe nuk kemi marr pergjiogje edhe spe ajo do ta lehtesone shumë punën si komunë. Sa i përket ujësellsit në Rubovc aty ak qenë një marrëveshje mes komunitetit dhe kompanisë qe komuniteti ti blej orëmatësit por ata nuk i kanë bler dhe ka mbet ashtu, dhe ne asnjë kompetencë nuk kemi në Ujësells, bile nuk kemi as aksionar. Rruga Marie Shllaku,

jemi në përpjeke për ta shkëputur kontratën e vjetër sepse kemi dhënë ne disa vërejtje atje, dhe duhet të gjejmë një zgjidhje për atë urë. Sa i përket investimeve në Jetën e Re, ka nevojë për investime por aty ka telashe me pronën siç po ka edhe në shumë lokalitete të tjera. Nuk jam në dijeni për emërime dhe rrimëime të rrugëve dhe rrugicave, por komisioni është në teren. Por si duket nuk ka interesim publik, por më shumë individual. Rentgeni është donacion por se di sa është funksional. Vërejtja e QKMF-së është aktive dhe punon. Memoriali i UÇK-së, në Shalë me kanqesi do të ju ndihmojmë dhe dio të jem pjesëmarrës dhe kontribues sa herë që është në pyetje kërkesa e qytetarëve.. Për orarin e biznesve rregullorja është në diskutim publik dhe seancën e ardhshme do ta kemi në kuvend. Në Varigovc disa familje nuk kanë mujt me u lidhur për shkak të konfiguracionit. Pyetja më e drejtë që ajo nga Fadili, për fletushkat, e për të cilën duhet të angazhohemi të gjithë. Sa i përket kriterëve për pranim teknik të objekteve nuk e di, por është në faqen e komunës dhe mund ta shihni. Sa i përket objektit të Kryqit të Kuq, në agjendën tonë kemi një objekt të ri të QKMF-së, dhe na do ta zgjedhim një model më të mirë, jemi të interesuar që aty të bëjmë një zgjidhje sa më të mirë për qytetarët. Në Janjevë, ne jemi duke bërë investime në bashku me UNDP dhe Ministrinë tre partner dhe aty do të bëhet kanalizimi dhe ujësjellsi të zgjidhet ky problem.

Shkelzen Hajdini, tha se Stomatologjia punon deri në ora 23:00, dhe në QKMF-ën për ankesat gjysmë milion shërbime brenda një viti, por aty është edhe kutia e ankesave dhe mund të bëni ankesa. Une jam i gatshëm për çdo bashkëpunim me secilin për çështjen e shëndetësisë. Sa i përket atyre aseteve aty është një komision që është duke u marrë me to. Rentgenin e kemi donacion. Sa i përket barnave pa recete të mjekut nuk është kompetencë e jona por ta paraqes këtë në nivel qendror, Web faqja është funksionale e QKMF-së.

Ganimete Qeriqi, tha se cili është vizioni yt dhe politikat tua për të ardhmen për familjet e martirëve si do ti menaxhoni, për shpërblim për banesë po për troje për të ardhmen.

Arsim Jashari, tha se sa e pranova një kërkesë prej këshillit të objektit të Eurokosit, është mirë të intervenohet pasi që ata aty po kanë problem. Une e pata për konkursin për zyrtar ligjor që është anuluar pse?

Alban Salihu, tha se në kur të ngrishim qështjet të ngrishim në emër të 1 apo më shumë të qytetarëve, pastaj drejtoritë përkatëse vëdosin se duhet të intervenohet ose jo. Une kërkoja që rezultatet e atyre që hyjnë në test të publikohen pikët e të gjithëve që e kalojnë testin.

Egzona Bytyqi,tha se faqja ndoshta tani qenka aktive, por nuk është qe ka aktivitete në të.

Lumturije Bytyqi-Hasani,, tha se rregullorja nuk po e shoh qe është në konsultim publik ne faqe te komunës.

Nexhemdin Lekiqi, tha se si po duket deri në fund të mandatit e vetmja pyetje në kuvend do të mbeten qentë endacak pasi qe këto tjerat thuaj se janë kryer të gjitha. Une e kam edhe një propozim qe numrat e drejtorve te jenë 24 orë në dizpocoon të qytetarëve ne menyre qe çdo qytatar te i theras per sdo parregullsi

Imri Ahmei, kryetar i komunës së Lipjanit tha, se objekti ku janë vendosur familjet te eurokosi ne kemi nderhyrjet disa herë dhe do të ndërhyjme përsëri.E rëndësishme është qe ata me gjetë një zgjodhidhje. Vizioni im është qe me punë të mira të ju përgjigjem qytetarëve.Dhe shumë i kam respektu çdo familje e ne vecanti këto te martirve dhe dëshmoreve. Qentë endacak, kontrat aka qenë në OSHP-dhe na është kthyer vendimi pozitiv dhe shumë shpejtë do ta fillojnë punen kjo kopmapni,qe te mos rrezikohet qytatarët. Ne seancen e ardhshme do te jet ne kuvend rregullorja per orarin e biznesve pasi qe tani është në konsultim publik.

Pasi qe çështje tjera nuk pati u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 15-të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, tha se kemi telashte te vazhdushme me proceverbal dhe duhet ti kushtohet me shumë kujdes dhe proceverbalet te cilat i mban personal me pas ndonje trajnim,për të gjitha komunat.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se e kemi kemi diskutuar këtë punë ne nivel të kolegjiunit të kryesuesve. Dhe disa komuna i shënojnë vetëm emrat e diskutantëve për shkak të transmetimeve qe po bëhen live.Dhe nuk ka një udhëzim adminsitrativ ose një rregullore qe e precizon saktë e këtyre ekstrakteve apo proceverbaleve.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 15 e Kuvendit, pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 29 vota për aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja 15-të e Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II.

Propozim Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15 Nr.011-43473 datë 28.06.2019.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Anila Reqica Llugiqi e ,i cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga rregullorja.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se pari ai kaloi fjalën Lumturie Bytyqi-Hasnai, e cila dje me ka dërguar një propozim për disa ndryshime të rregullores

Lumturie Bytyqi-Hasani, tha se pari do të duhej që anëtarët e kuvendit ta kishin propozimin tim përpara. Unë kam kërkuar që të ndryshohet neni i 10-të i rregullores dhe të shtohet ndihma për lehonat, unë kam propozuar që të shtohen nënparagrafi 5, që do të ishte, grave lehona që lindin foshnje dhe të nënparagrafi 8 fletëshimi nga organi përkatës dhe certifikata e lindjes që kërkohet për të përfituar nga ky subvencion, unë këtë propozim e kam bërë për shkak të rritjes së cmimeve dhe disa komuna tani e kam bërë këtë propozim. Propozimi im është të ndryshohet kjo pjesë pastaj me një vendim tjetër të caktohet shuma kur të jetë buxheti. Pres që ky propozim të mbeshtetet.

Daut Azemi, tha se kërkesa ka qenë jashtë afateve, por unë prap ta dhashë të drejtën ta prezentosh.

Anila Reqica-Llugiqi, tha se i përket propozimin ka implikim buxhetore, rregullorja e më hershme nuk e pamundeson një ndihmë të tillë.

Lumturie Bytyqi-Hasani, tha propozimi im është që ta ndryshojmë këtë në rregullore, ndërsa me një vendim tjetër të caktohet shuma. Nëse ka vullnet ka modalitet prej komunave të tjera.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Fadil Spahiu, tha se unë kam një Propozim te Neni 9 paragrafi 4 për ndarjen e subvencioneve në bujqësi, me që procesi i ndarjes së subvencioneve fillon përmes shpalljeve publike të cilat publikohen në faqen e Komunës, te thirrja publike kërkoj që këti paragrafi përveç njoftimit në faqe zyrtare të Komunës t'i shtohet që njoftimi të dërgohet edhe në mediat lokale dhe në vendet më të frekuentuara në territorin e Komunës. Duke u bazuar në punën dhe aktivitetet e vrullshme të sektorit të bujqësisë këtë kërkesë për tendencë të zgjerimit të informacionit e bëjë për arsyeje të njoftimit sa më të mirë të mundshme për të gjithë të interesuarëve për aplikim për subvencioneve në bujqësi. Pra, propozoj që ky paragraf të jetë kështu: Thirrja publike për ndarjen e subvencioneve në bujqësi duhe të publikohet në faqen zyrtare të Komunës, në mediat lokale dhe në vendet më të frekuentuara në territorin e Komunës dhe të jetë e hapur së paku 15 ditë kalendarik. Më tej paragrafi të vazhdoj ashtu siqë është në Propozim për ndryshim dhe plotësim. Ndërsa te Neni 2 dhe 11 e mbështes në tërsi Propozimin për ndryshimin dhe plotësimin e dispozitave të kësaj Rregullore për ndarjen e subvencioneve.

Egzona Bytyqi, tha se edhe në KPF e kemi elaburu, une do të ndalem te neni 11 paragrafi 18, te subvencionet e praktikantëve, do të ishte mire qe këtu te hyjnë edhe praktikantët te cilët e kryjnë praktikën në QKMF.

Shahadije Dragaçina, tha se te neni i 4, i kësaj rregullore thuhet se per shumën mbi 2 mijë euro nevojitet propozimi i kuvendit, ne si grup i LVV-së, kemi dyshimet tona se ky ndryshim i këtij paragrafit e privon kuvendin dhe neve si asambleistë, pasi qe me këtë ndryshim keni lënë hapsirë të manovrimit në bazë të vullnetit tuaj për ndarjen e subvencioneve, dhe për këtë duam një sqarim. Dhe ne me këtë ne nuk pajtohemi si grup.

Daut Azemi, tha ju kisha lut qe te fokusoheni te tema jo te merrni me qeshtje qe nuk janë kompetencë e juaja dhe krijoni kulture të kuvendit pak. Ajo qe na takon si kuvend po e diskutojme jo ajo qe nuk na perket neve.

Arsim Jashari, tha se une jam i mendimit qe shuma mbi 2 mij euro me ardh në kuvend, dhe ne si kuvend me marr vendim.

Albiona Tasholli, tha se sa i përket propozimin te koleges, ky propozim ka ardhë me vonesë, dhe ju nuk e keni hallin e lehonave por hallin e poenave politikë, pasi qe kur janë nda mjetet per subvencioent ne buxhet ju e keni kundërshtuar.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se nuk është qellimi i kësaj rregullore qe shumën mbi 2 mijë euro me nda kujt te doj kryetari, por këto mjete prap do të vijnë në

kuvend. Na i kemi mjetet e ndara per subvencione dhe nuk mujna na pershmebull per cdo bursist me pru me votu në Kuvend. Ideja është me i lehtësuar shpenzimet e parasë.

Arsim Jashari, tha se çdo punë e mirë duhet me planifikuar, por kur të planifikohet me ardhë përmes kuvendit.

Anila Reqica-Llugiqi,tha se pagesa per praktikant do te paguhen ata qe i nënshtrohen nje konkursi ndërsa ata ne shëndetësi me kërkesë. Infromimi bëhet cdo herë dhe qëndron e hapur 15 ditë ne faqen e komunës

Fadil Spahiu, tha është mirë'i shtohet që njoftimi të dërgohet edhe në mediat lokale dhe në vendet më të frekuentuara në territorin e Komunës,pershmebull në secilin fshat nga një njoftim

Arsim Jashari, tha se te afati i ankesave do të ishte mire qe të shtohet ose 5 ditë pune ose 7 ditë kalendarike.

Egzona Bytyqi, tha do të ishte mire qe me hy këtu në rregullore edhe praktikantët të cilët e bëjnë praktikën në QKMF-

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se na i kemi nda buxhetin për adminstratë, por duhet qe herat tjera me para edhe në shëndetësi me parapa në buxhet. Po pajtohna te shtohet afati te jetë 15 ditë.

Arsim Jashari, do te ishet mire qe te jetë 7 ditë kalendarike.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se pari po e qes propozimin e anëtares se kuevdnit Lumturie Bytyqi-Hasani, ne votim.

Pas votimit u konstatatua se Kuvendi me 14 vota për, 17 kundër nuk kaloi propozimi i anëtares se kuevdnit.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës së Lipjanit, tha se ne nuk kemi asnjë listë të mediave lokale, a e dini ju se na me ligj jemi të detyruar ti dërgojme në gazetë, esot nuk ka gazeta sot, nuk lexon askush.

Fadil Spahiu, tha se njoftimet te behen ne vendet me te frekuentuara.

Imri Ahmeti, une mendoj qe ne protale është jo e drejtë pasi qe nuk ka listë te mediave lokale.

Arsim Jashari, ne çdo herë ju kemi mbështet, ju nuk na mbështetet, pasi qe ne kemi qenë konstruktiv çdo herë.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e rregullores, qe afati i ankesave nga 5 ditë të jetë në 15 ditë, dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 16 vota për, 13 kundër aprovoi rregulloren

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit dha pauze, nga ora 12:30 deri në 14:00

Pjesa e dytë filloi në ora 14:15

III

Propozim Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia kaloi fjalën Safete Amerllahu e cila i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi, hapi diskutimin?

Abiona Tasholli, tha se ne si grup i LDK-së për anëtar të komisionit e propozojmë, Sami Bytyqin

Arsaim Jashari, tha se në emër të grupit të PDK-së, e propozojmë Ganimete Qeriqi

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, 4 abstenime aprovoi Vendim

IV

Raporti Janar - Dhjetor 2022 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorive Komunale.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia kaloi fjalën Imri Ahmeti, kryetar i komunës së Lipjanit i cili i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Raporti.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se sa i përket raportit une dua te ndalem te raporti i Avokates publike komunale pasi qe edhe vi nga fusha juridike,ku kam bere nje krahasim lendet ne vitin 2021 dhe 2022 ku ne 2021 ne procedur kane qene 1224 lende, te perfunduara kane qene 204 lende. Ndersa ne vitin 2022 ne procedur kan qene 1755 lande, ndersa te perfunduara 124 lande. Mbrenda nje viti 531 lend i kemi ma shum.2021 80 lend jan perfunduar me shum se 2022.Nese i shiqojme lendet tek permbaruesi borgji gjdo vite po rritet deri me tani jane mbi 300.000 euro plus komata dhe shpenzimt adiminstrative. dhe kush demtohet ketu bugjeti i komunes, une edi qe ministra perkatese ka lidhur marveshje me sindikat e arsimit dhe shendetesis dhe per keto marveshje nuk ka ndar bugjet te veqant, po ashtu e di qe kryetri ka kerkuar nga ministria perkatese per ti kompenzuar demet financiare qe pi shkaktojne keto kategori per te cilen mendoj qe puntoret kane te drejt absolute ne kete kerkesë.Po flas per shperblimet jubilarë dhe kompenzimin ne rast penzionimi qe jane tri paga. Marveshja kolektive ka qen per vitet 2015-16-17 per tri vite dmth te gjithë ata puntor te cilet mbrenda ketyre viteve 15-16-17 kane pas provoj pune 10-20 ose 30 vjeqare juka takuar nje pag dy ose tri paga. Dhe deri ketu jemi ne rregull, por mbrenda kesaj marveshje egziston nje nen i cili specifikon se deri ne nje kontrat te re kjo marveshje jete ne fuqi dhe ketu te gjithë avokatet te cilet i perfaqesojne puntoret, jane thirrur pikrisht ne kete nen dhe jane duke i fituar lendet dhe duke demtuar bugjetin e komunes. Me 23.11.2022, ministrin perkatese ekan nderpre kete marveshje me sindikatat, dhe puntoret nuk kane me te drejt per konpenzim apo padi evntuale, me sa kam une informata deri vitin 2020 , lendet kane perfunduar kane mbetur 2 vite, Atehere une kam nje propozim qe komuna te futet ne marveshje me gjykate dhe avokat, eshte nje propozim qe avokatit ti paguhet vetem nje seanc dhe te perfundojne me nje seancë te vetme po flas per lendet qe jane ne procedur, edhe puntoret kane me qene te knaqur edhe bugjeti i komunes komu demtu ma pak. Per ndryhe permbruesi kome blloku llogarit dhe zyrtaret ligjor me shum kane me qen ne seanca se ne zyret e veta, dhe te gjitha lendet komuna ko mi humbur, Nese i llogaritni komatat dhe shpenzimet ne baz te tarifës se odes se avokateve del qe komuna kome pagu dyfishin e obligimeve.

Këtu duhet te gjindet nje zgjidhje e cila do te ishte e favorshme per te dya palet. Dhe ka qen nje premtim i kryetarit besoj qe kryetari para se me dhane premtimin ka bere nje analiz per kete raste.

Besiana Syla, tha se një raport qe paraqet më shumë vetëknaqesi dhe aspak nuk është vetëkritik. Për me qenë raporti korrekt duhet të krahasohet me diçka,sepse nuk e dijmë cilat punë kanë mbet pa u kryer,këtu shihen vetëm shifra pa kurfar krahasimi.Shembull konkret e kemi te investimet kapitale ku këto investime nuk kanë

fare qëndrueshmëri, ku shumë projekte janë kryer pa kurrfar kriteri dhe verehen defektet. Te subvencionet bëhen pa kurrfar raporti. Po ashtu një investim paraqitet në disa venda, ku për këto kërkoj edhe një sçarim.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës, tha se sa i përket lëndëve të cilat po shkojnë të përmabruarit në si komunën po demtohen, por në nuk jemi palë të nënshkrimit të marrveshjes, palë nënshkruese kanë qenë minsitritë, dhe asnjëherë asnjë komunë nuk ju ka lejuar mi pagu. Na pagat përcjellse i kemi dhanë deri në dhjetorin e vitit të kaluar. Por na po kemi talashe me shujtje dhe me ato të udhëtimit. Është një problem që do të vazhdoj, por është e pa drejtë edhe ndaj punëtorve kjo. Une kam prevuar me shkurtuar raportin dhe aty në raport janë përfshira të gjitha projektet dhe të gjitha punët e ekzekutivit. Dhe aty nuk ka asgjë të shtuar as të hiquar.

Shahdije Bikliqi, tha se, kemi një raport më shumë statistikor dhe me shumë numra. Raporti fillon me lavdatat e kryetarit duke e lavdruar veten e të cilat në realitet janë krejt ndryshe. Në raport flitet për zonën ekonomike në qyllage por nuk flitet edhe sa kohë duhet që ajo zonë të funksionalizohet dhe a ka biznese të interesuara për atë vend. Po ashtu nuk kemi funksionale edhe tergun e gjelbert e as stadiumet në Dobrajë e Magure.

Fitim Mëziu, tha një raport vuliminoz, une do të fokusohem të shëndetësisë, dhe QPS-ja, shëndetësia në Lipjan, dhe bazamanti i shëndetësisë fillon nga kujdesi primar dhe nëse nëse nuk e rregullojmë kujdesin primar ai sekondar, nuk do të ketë ardhmëri të mirë. Mjeku familjar e shikon konceptin mjekësor në aspektin horezinatal. QKMF-ja, ka pas plotë pilot projekte, por do të duhet që ato të jenë ato në të mirën e qytetarëve. Është mirë që në kuadër të QKMF-së, të formohen disa trupa profesionale që kishin me dhënë kontribut në avnacinë e mjekësisë familjare, pasi që shëndetësia nuk është në gjendje të mirë dhe neve çdo ditë po na ikon mejtët dhe specialistët e mjekësisë. Dhe ende po mungon numri adekuat i mjekve në komunën tonë. Një numër i madh i analziave ka filluar të bëhet. Po ashtu kërkoj që pjesa e Emergjencës, të bëhet një trajnim dhe të jenë të certifikuar, mungon aty edhe një organizim adekuat. Trupat që do të ishin të nevojshëm për me funksionalizuar QKMF, janë: këshilli profesional, komisioni disiplinor që egziston tani, por të jet vetmas komisioni i ankesave, komiteti për cilësi të shërbimeve, dhe komiteti për zhvillim dhe promovim shëndetësor.

Alban Salihu, tha se para vetës kemi një raport të skandaleve dhe keqpërdorimeve, ku dua të theksoj se viti që e lëm pas ka qenë viti ku kemi prodhuar më së shumti skandale dhe jo në raport me vitet e ardhshme por edhe në raport edhe

me komunat e tjera. Një ndër objektivat kryesore ka qenë keqperdorimi i buxhetit e sidomos te investimet kapitale e ku arrijen me te madhe kemi ne rregullimin e stadioneve ne Magure dhe ne Dobraje, ku ne dy projekte janë keqperdor afër 600 mij euro e ku ka pas edhe arrestime per to. Kane qene edhe disa projekte te emdha si lifti ne QKMF, dhe demtimi i disa shkollave. Ne sport kemi arrit te refuzojme nje kerkese te FFK-së, po ashtu kemi vazhduar te jepin leje ndertimore pa asnje kriter.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha, se njëri diskutant tha se ka shume fjale te shkruara e tjera shume statistika, eshte mire me u marr vehs ne mes veti, dhe une nuk bëjë raporte për qefin e askujt po për punën time. Gjatë mandatit tim janë rregulloar 45 fusha te hapura sportive ne secilin fshat, gjat manadatit tim ne secilen shkolle kemi nxemje qendrore e shumë shkolla janë renovuar e disa edhe janë ndërtuar. Une jam krenar me punen time dhe te te gjithë zyrtarve te komunës.

Nexhemdin Lekiqi, tha se na nga raporti pam shumë projekte, nese ne 74 faqe te raportit opozita nuk gjen asnje te mire, kjo i bjen qe janë në drepesion . Punet qe i ka bër ky ekzekutiv duken shumë dhe atë po i shohin të gjithë qytetarët. Dhe duhet te shihen gjërat e mire, por nëse ka nevojë për kritike bën, por jo te hyhet ne gjëra personale.

Lulzim Rrustemi, tha se një raport vuliminoz dhe i pershkruar ne detale, këtë raport e kam shikuar kam disa vërejtje, e para te sektori me mardhenje em publikun, faqja e komunës nuk është veq e kryetarit por edhe e kuvendit dhe e qytetarve, dhe duhet me ndryshu dicka mwe shumë për të miren e qytetarve. Te informimi thuhet se seancat e kuevdnit, jane dal live ne youtube, e kjo nuk është e vërtetë. Te raportet e auditimit, te menaxhimi i kontratave a ka ka lëshu ndonje rekomandim per stadiumet ne Dobraje dhe Magure. Te sektori për përfaqesim ligjor, neve na janë kthyer disa vendime negativ nga ana e minsitrive. Te adimistrata, drejtoria ka pas neglizhencë te zgjidhje e keshillave te fshtrave, dhe këtë se kka paraqit. Sa i perket Arsimit, ne nuk kemi pas asnjë informate nga DKA-ja, brenda vitit. I kemi nda 175 bursa por 9 studentë qe studjojnë jashtë kosoves kane mbet pa asnjë ndihmë financiare. Rezultatet e testit te arritshmerise, mbi 50: e kanë kalua pak shkolla. Te testi i matures te shkolla Adem Gllavica, shumë dobt kalimi, dhe diferenca me Ulpianen është e madhe. Po ashtu kemi disa nxënës të pa notuar në shkollat fillore po ashtu edhe shumë mungesa, cka po ndodh em këta nxënësit e pa notuar. Po ashtu kemi probleme te zevendesimet e mesimdhënesve, gjat shkuarsjes ne pushim të lehonise, dhe tani po zevendesohen em persona jo adekuat. Drejtoria e infsatrutures është e vetmja e cila i ka paraqitur disa sfida. Te DKRS-ja, nuk kemi asnjë sfide ashtu edhe te drejtorattet tjera. Te bxheti kemi shumë mjete qe janë shkuar suficit. Te drejtorati per Ekonomi dhe Zhvillim, duhet me

ju dhënë kujdes me shumë biznesve dhe me i dhanë zhvillim Lipjanit, me ata që janë më të kujdesshëm. Te shërbimet publike të emnaxhimi i tregejve nuk janë paraqitur sfidat. Por aporti ka edhe anë pozitive, siq është të tatimi në pronë, por vërejtje që i dham duhet emrren parasysh.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se, unë thash që nuk ka asgjë ideale, por ne jemi mundu me kry një raport sa me të mirë, dhe Lipjani përmendet për të mirë nga shumë organizata vendore dhe ndërkombtare dhe është duke u shënuar progres çdo ditë me krahasu me komunat tjera. Unë uroj që të ketë investime në zonën ekonomike. Qështja e ikjes së puntorve është trend i përgjithshëm, jo vetëm në komunën tonë. Te vebfaqja, është shpall me të mirë në të gjithë Kosovën, nga të gjitha organizatat. Kthimi i vendimeve nga niveli qendror është shqetësuese jo vetëm për komunën tonë [por edhe për komunat tjera. Neve na kanë humb mjetet të grantet jo të kapitalit, e kështu shumë kanë ndikuar OSHP-ja, për shkak të mos trajtimit të ankesave. Unë jam i kënaqur me rezultatet e deritanishme.

Egzona Bytyqi, tha se sa i përket raportit, unë do të na lejmë të shëndetësia, dhe ne e krahasojmë me vitin e kaluar ka progres. Ne si grup çdo herë jemi mundu me dhënë kontribut. E kam një pyetje, a kanë bërë kërkesë për doktor të ofrimit të sëmundjes së mushkrive.

Lumturie Bytyqi-Hasani, tha se, ekam një pyetje, të drejtoria e prokurimit, është një tender për një operatör që me shfaq punën e komunës, pse është bërë kjo?

Sami Bytyqi, tha se disa diskutime të cilat i paten disa diskutues, kanë të pa vend. Unë do të përmendi disa projekte të cilat janë realizuar siç janë infrastruktura rrugore, duke lidhur shumë fshatra në mes vetë, po ashtu edhe me ndriçim, kanalizim ujësjellës, pastrim të lumenjëve. Po ashtu ndërtim të shkollave, stadiumeve, fushave sportive e në veqanti ndërtimi i sheshit Adem Jashari. Po ashtu kujdes të madh ju ka kushtuar studentëve duke ju ndar bursa, dhe subvencione të ndryshme për bujqë. Por puna më e mirë është bërë ndërtimi i objektit të ri të komunës. Dhe Lipjani është shpallë që disa vite si komuna më e mirë si nga organizatat vendore ashtu edhe ato ndërkombëtare, dhe qytetarët janë duke e vlerësuar [punën e kryetarit.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës së Lipjanit tha se, sa i përket nxënësve të pa notuar janë nxënës që kanë kaluar nga një shkollë në tjetrën, ose jashtë shtetit, ndërsa sa i përket kompanisë për publikim ato na kanë obliguar që të lidh për ato është bërë

Alban Salihi, projektet janë bërë, por me taksa të qytetarëve, dhe stadiumi në Lipjan është bërë në bashkëfinancim.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se është akatakuze te kosntatosh se ka keqmenaxhim, mundeni me thënë unë mendoj, e jo me konstatuar. Une kërkoj qe te gjeni alternativa e jo konstatime.

Arsim Jashari, tha se nese kritikojme me fakte ju nuk duhet me u hidhëruar dhe jo me i perfshi krejt shabllon.

Nexhmedin Lekqiqi, tha se une nuk dhash konstatim dhash mendim qe kur te kritikohet duhet te argumetohet.

Pastaj u kalua në pikën në vijim.

V

Propozim Vendim për aprovimin e listës së projekteve kapitale me prioritet për bashkëfinancim për vitin 2023

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia kaloi fjalën Sead Aliu i cili i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Bashkim Budakova, tha se e kam një popozim qe te në kuadër të kësaj liste te futet edhe projekti i rrugës Lipjan, Rubovc, e cila është ndërprerë për shkak të rritjes së çimeve.

Alban Salihu, tha se une e kamshqetsimin te ndertimi i staudumit në Dobrajë dhe Mgaure, faza e 3-të, ku ne nje pronocim per media te komunës është thënë se stadiumet janë përfunduar dhe tash i mbetet klubeve te i mirmbajne, pse tash duhet me invetu prap aty. Për aprovimin e listës së projekteve kapitale me prioritet për bashkëfinancim për vitin 2023

Fadil Spahiu, tha se duke u bazuar në aryetimin e këtij Propozim Vendimi, që qëllimi i këtij Propozim Vendimi është që Komuna e Lipjanit me këto projekte planifikon të aplikoj te donatorët e ndryshëm dhe te Ministritë e Republikës së Kosovës, e që si parakush për të aplikuar për përkrahje në këto projekte kërkohet që këto projekte të aprovohen nga Kuvendi Komunal dhe me që aprovimi i këtyre projektëve Komunës së Lipjanit i hap rrugën për aplikim në thirrjet e shpallura nga donatorët e ndryshëm dhe Ministritë e Republikës së Kosovës dhe rritjen e transparencës së informimit të publikut rreth aprovimit të projekteve të caktuara e mbështes në tërsi këtë Propozim Vendim.

Arsim Jashari, tha se disa projekte shumë të nevojshme per qytetarët e komunës së Lipjanit, dhe në emër te grupit të PDK-së, e mbështesim.

Lulzim Rrustemi, tha se e perkrahi shefin e grupit të PDK-së, por e kam një propozim, qe asfaltimi i rrugicave kur të bëhet të ketë një standart, pasi qe po ka ne disa vende po i kanë te shtuara edhe rrugën deri ne oborr deri te vllaznillaku. Pasi qe ato mjete mudnemi me i shti në shëndetësi ose në arsim.

Rinor Murati, tha se seancen e kalume e kam ngrit nevojën per një qenër per down sindrom dhe autizëm, kërkoj qe edhe ky projekt të listohet dhe të trajtohet me prioritet.

Lumturie Bytyqi-Hasani, tha se kryetari e ka pas një premtim publik, per ndertimin e nje qendre te persnoave me nevoja të veçanta, dhe propozoj qe edhe ky projekt të listohet.

Imri Ahmeti,kryetar i komunës tha se këto projekte nuk do me thane qe do të kryhen 100%,por ne i dergojmë dhe aplikojmë ne grante te ndryshme. Rruga e Rubofcit është ende e koduar në Ministri, dhe pse ka pak mjete, por na do ta shohim edhe me rishikim, por ne do ta shohim atje edhe shtigjetee ecjes. Objektin per persona em autizëm e kemi menuar, por nuk kemi prone publike, por te QKMF-ja, do ta shohim mundësinë për të ardhmen, ose si kuvend duhet ta gjejmë një pronë.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, 3 abstenime aprovoi Vendim

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 16:10

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi